



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:230158

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05830095

Ac.nr.2578/2020

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Naim Mehulli - kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Liridon Maloku, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore kontestimore të paditësit N.A. nga fsh., Komuna Gj....., të cilin e përfaqëson me autorizim Hazir Haziri, avokat nga Gjilani, ndaj të paditurve: Xh.M. dhe H.H., të dy nga fsh....., Komuna e Gj....., për vërtetim pronësie, duke vendosur sipas ankesës të paditurit të dytë H.H., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.903/2019, i datës 13.02.2020, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 11.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e të paditurit të dytë H.H., PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.903/2019, i datës 13.02.2020 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.903/2019 të datës 13.02.2020, ka vendosur si në vijim: **“I. APROVOHET** si e bazuar kërkesëpapia e paditësit N.A. nga fsh....., Komuna e Gj....., e paraqitur ndaj të paditurve: Xh.M. dhe H.H., dhe **VËRTETOHET** se paditësi Nexhmedin Aliu, në bazë të marrëveshjes gojore mbi shitblerjen e paluajtshme është pronar me 2/7 e pjesës ideale të pronës e paluajtshme me nr. të njësisë kadastrale P-7043039-01995-0 me numër të lëndës 114762-2019 e datës 13.09.2019 e cila në Drejtorinë për Gjeodizi, Kadastër dhe Pronë evidentohet në emër të bashkëpronarëve: A.J., M.Q, H.Z., M.Z., A.H, H.S., të gjithë me nga 1/7 e pjesës ideale dhe DETYROHEN të paditurit që këtë të drejtë të ia njohin paditësit duke e lejuar bartjen dhe regjistrimin e kësaj paluajtshmërie në pronësi, ashtu që ky aktgjykim pas plotfuqishmërisë do të shërbej si bazë për regjistrimin e kësaj prone në emër të paditësit në evidencat kadastrale në Komunën e Gj.....”

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i padituri i dytë H.H., dhe atë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ashtu që paditësit ti refuzohet papia, ose lënda të prishet në tërësi dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë për ndryshim.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditurës është e bazuar. _____

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi N.A. ka paraqitur padi pranë gjykatës së shkallës së parë me datë 11.10.2019, kundër dy të paditurve, me përmbajtjen në padi që thuhet se babai i paditësit kishte lidhur kontratë mbi shitblerjen e tokës me gjyshin e të paditurit të parë në vitin 1980, për njësinë kadastrale P-7043039-01995-0 në Fsh....., Gj....., në vendin e quajtur "Sh....." dhe atë në sipërfaqe prej 350 m² nga gjithsej 6767 m² sipërfaqe e përgjithshme, me kulturë livadh i klasit të I-rë në shumë prej 9,000 banka (tani 5,000 euro), pagesë e bërë menjëherë. Disa vite më parë, gjyshi i të paditurit të parë e kishte blerë edhe pjesën e tokës nga i padituri i dytë, e që ishin bërë bashkëpronarë me nga 1/7 të pjesës ideale. Kurse pas marrëveshjes për shitblerje, shitësi i kishte marrë paratë, kurse blerësi e kishte shfrytëzuar tokën pa shqetësime. Ne seancën e dt.13.02.2020 paditësi e ka precizuar kërkesëpadinë ku ka kërkuar që të njëjtit ti njihet pronësia ne 2/7 të parcelës 0199-0, meqenëse të paditurit e kanë pranuar kërkesëpadinë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka caktuar seancat e shqyrtimit kryesor dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.903/19, i datës 13.02.2020, me të cilin e ka aprovuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se Gjykata në kuptim të nenit 148 pika 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore pas pohimit të kërkesëpadisë nga të paditurit ka konstatuar se në rastin konkret është fjala për kërkesa më të cilat palët mund të disponojnë lirisht, prandaj në kuptim të nenit 148 pika 1 të LPK-së gjykata pa shqyrtim të mëtutjeshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë, rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejt dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n) dhe k), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 pika 4 dhe 5 të LPK-së. Gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, me çka ka ardhur edhe gjerë tek zbatimin apo aplikimin e gabuar të drejtës materiale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika n), 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, për faktin se aktgjykimi i atakuar, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti aktgjykim nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata i është referuar dispozitave materiale juridike të cilat i ka cituar si përmbajtje, por nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale-juridike jep përfundimin mbi themelësinë e kërkesëpadisë.

Kjo Gjykatë po ashtu vëren se gjatë zhvillimit të kësaj procedure kontestimore, si i paditur i parë është përcaktuar Xh.M dhe si i paditur i dytë është caktuar H.H. ndërsa palujtshmeria

evidentohet ne emër të A.J., M.Q, H.Z., M.Z., A.H, H.S., të gjithë me nga 1/7, ku gjykata e shkallës së parë me asnjë prove të vetëm (certifikatë) nuk e ka vërtetuar se te paditurit janë trashigimitrat te personave që evidentohen si bashkëpronar, si pretendohet në këtë çështje.

Qëndron pretendimi ankimor i palës së paditëse në raport me gjendjen faktike, sepse gjykata i ka vlerësuar provat, mirëpo me rastin e vlerësimit të tyre në kuptim të besueshmërisë e njëjta nuk ka dhënë arsye të duhura, cilat kanë qenë provat dominuese që kanë ndikuar në vendimmarrje. Gjykata në rastin në fjalë ka pasur detyrim të vlerësojë pretendimet që rrjedhin nga padia për vërtetim pronësie, gjë që gjykata nuk ka dhënë arsye të duhura dhe të nevojshme për secilën bazë. Ka qenë detyrë e gjykatës që të vërtetojë se paditësi a e ka blerë pjesën kontestuese, nëse i njëjti e ka blerë a e ka poseduar pronën kontestuese dhe nëse i njëjti e ka poseduar nga cili vit e mban të njëjtën, po ashtu të konstatohet se kush e shfrytëzon tani të njëjtën në teren dhe krejt në fund të vendos në raport me padinë për vërtetim pronësie mbi bazën e parashkrimit fitues.

Si shkak i vërtetimit jo të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka ardhur edhe deri të zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, për të cilën gjykata ankimore kujdeset sipas detyrës zyrtare, me çka mbi bazën e shkeljeve të konstatuara aktgjykimi i atakuar u dashtë që te prishet dhe të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Nga arsyet e lartcekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave të sipërcituara, të cilat në ri procedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që udhëzohet gjykata e shkallës së parë që me rastin e shqyrtimit të çështjes të vlerësojë të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, ti administrojë të gjitha provat përkatëse relevante për vërtetimin e fakteve, te vërtetohet fakti se kush janë pasardhësit e personave që evidentohen si bashkëpronar, në rastin konkret të nxjerrët ekspertiza e gjeodezisë, të sigurojë historianit e pronës së paluajtshme për pronën konkrete me qëllim të vërtetimit të prejardhjes së parcelës lëndore dhe pas administrimit dhe vlerësimit të tyre, secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku në lidhshmëri me njëra-tjetrën, të vendosë në mënyrë meritorë për themelësinë e kërkesëpadisë duke u bazuar në dispozitat e të drejtës materiale dhe në atë mënyrë të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë, duke e arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme, e i cili në pikëpamje formale dhe materiale duhet të jetë në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata po ashtu në rigjykim sipas kërkesës së palëve në procedurë të vendos në mënyrë të drejtë edhe lidhur me shpenzimet e shkaktuara palëve në procedurë, duke pasur parasysh suksesin e tyre në procedurë dhe shpenzimet të cilat kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes së tyre në gjykatë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 paragraf 1 pika c) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2578/2020, me datë 11.06.2024

Kryetari i kolegjit
Naim Mehulli, d.v